

Datë: 04.10.2023

## STATUT & AKT THEMELIM

### I

#### SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### "The Brief Agency SHPK"

Në mbështetje të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërítë Tregtare", - i ndryshuar, Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" – i ndryshuar, veprimtaria e shoqërisë do të organizohet dhe drejtohet sipas dispozitave të këtij Statuti.

#### Neni 1

#### Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me Statutin dhe legjislacionin shqiptar.

#### Neni 2

#### Ortakët e shoqërisë

Ortakët e shoqërisë janë:

1. **GENTIAN MINGA**, lindur më 05.10.1983 në Tiranë dhe banues në adresën Rapo Hekali, 32/2 1001, Tiranë, me Nr ID – I31005023H.

#### Neni 3

#### Forma ligjore

Shoqëria ka formën e "shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar" ose "SHPK". Megjithatë, ajo mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

#### Neni 4

#### Kohëzgjatja e veprimtarisë

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është i papërcaktuar.

#### Neni 5

#### Selia

- 5.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Ruga "Rapo Hekali", 32/2 1001, Tiranë**.
- 5.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

#### Neni 6



### **Dokumentet e shoqërisë**

- 6.1. Të gjitha shkresat, formularët e urdhrale apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përbajnë, përveç emrit të shoqërisë edhe të dhënët e mëposhtme:
- a) *numrin unik të identifikimit;*
  - b) *formën ligjore të shoqërisë;*
  - c) *vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;*
  - d) *të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;*
  - d) *vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit;*
- 6.2. Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

### **Neni 7**

#### **Objekti i veprimtarisë**

- 7.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

***Ekspert per marrëdhieniet me publikun. Shërbime përkthimi. Realizim videoesh, Fushata PR, Organizim eventesh PR, Produksione televizive. Shërbime PR. Media Buying, Fushata Digitale, Aktivizim influencers, BTL, Prodhime matëriale promocionale, zhvillime aplikacionesh dhe website për qëllime komunikimi dhe PR.***

- 7.2 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

### **Neni 8**

#### **Kapitali themeltar**

- 8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **ALL 100.000 (njëqind mijë lekë).**
- 8.2 Kapitali përbëhet nga **2 (dy) pjesë/kuotë:**
- *Ortaku, GENTIAN MINGA zotëron 100% të kapitalit themeltar, ose 1 (një) pjesë/kuotë, me vlerë nominale 100.000 ALL (Njëqindmijë lekë).*



**Neni 9**  
**Transferimi i pjesëve të kapitalit**

- 9.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm në rast trashëgimie, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve apo paraardhësve e pasardhësve.
- 9.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek të tretët, qofshin këta subjekte shqiptarë apo të huaj, persona fizikë apo juridikë.

**Neni 10**  
**Zmadhimi/zvogëlimi i kapitalit**

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

**Neni 11**  
**Asambleja e Ortakëve**

- 11.1 Asambleja e Ortakëve përbëhet nga ortakët e shoqërisë. Ajo drejtohet nga administratori i shoqërisë ose nga çdo person tjetër i zgjedhur nga ortakët.
- 11.2 Asambleja e ortakëve ka këto kompetenca kryesore:
  - ndryshimi i dispozitave të statutit,
  - zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit,
  - emërimi dhe ndryshimi i administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,
  - miratimi i shpërblimeve të administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,
  - miratimi i llogarive vjetore(bilancit),
  - ndryshimi i formës ligjore të shoqërisë,
  - mbyllja dhe shpërndarja e parakohshme shoqërisë si dhe të tjera të përcaktuara në legjislacionin shqiptar tregtar në fuqi.
- 11.3 Asambleja e ortakëve mblidhet të paktën një herë në vit dhe sa herë që duhet të vendosë për çështje të kompetencës së saj. Mbledhja mund të realizohet edhe nëpërmjet video-konferencës.
- 11.4 Mbledhja e Asamblesë thirret nga Administratori ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar. Asambleja thirret me anë të një njoftimi me shkrim që u dërgohet ortakëve të paktën shtatë ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi mund të dërgohet edhe nëpërmjet postës elektronike por në çdo rast duhet të përmbarajë ditën, orën, vedin si dhe rendin e ditës me çështjet që do të trajtohen.



- 11.5 Ortakët mund të përfaqësohen në mbledhje nga persona të tjerë, bazuar në një prokurë të lëshuar paraprakisht, prej tyre.

### **Neni 12**

#### **Vendimmarrja**

- 12.1 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kapitalit të shoqërisë.
- 12.2 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë.
- 12.3 Asambleja e shoqërisë, vendos me 75% të kapitalit pjesëmarrës (të përfaqësuar nga ortakët), siç parashikohet në pikën 12.2 më sipër, për ndryshimin e statutit, zmadhimin dhe zgjedhimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Në rastet e tjera, asambleja e shoqërisë, vendos me më shumë se 50% të votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.
- 12.4 Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në një procesverbal, ku shënohet data, vendi, rendi i ditës, emri i drejtuesit të mbledhjes dhe mbajtësit të procesverbalit, çështjet kryesore dhe vendimet e marra. Prosesverbalit nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari (mbajtësi i procesverbalit).

### **Neni 13**

#### **Administratori**

- 13.1 Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Administratori zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- 13.2 Shoqëria drejtohet nga 1 administrator, e cila është **Z. Gentian Minga**.
- 13.3 Administratori, ndër të tjera, ka të drejtë: të drejtojë veprimtarinë e përditshme të shoqërisë, të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, të paraqesë para Asamblesë së ortakëve propozime dhe raporte lidhur me aktivitetin e shoqërisë, të çelë llogari bankare në emër të shoqërisë, si dhe të drejta të tjera të cilat mund t'i njihen nga ligji dhe Asambleja e ortakëve.
- 13.4 Administratori, bazuar në një vendim të asamblesë së ortakëve, mund të emërojë drejtorë, përfaqësues me prokurë dhe të mandatuar të përgjithshëm për veprime të caktuara ose kategori veprimesh.



13.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të shesë dhe/ose blejë pasuri të paluajtshme në emër dhe pér llogari të shoqërisë, pa marrë më parë miratimin paraprak me shkrim të asamblesë së ortakëve.

#### **Neni 14**

##### **Kontrolli financiar**

Asambleja e Ortakëve mund të emërojë një apo disa ekspertë kontabël të cilët kanë detyrën të kryejnë kontrollin kontabël dhe financiar të shoqërisë.

#### **Neni 15**

##### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.

#### **Neni 16**

##### **Bilanci dhe Dividendët**

- 16.1 Në fund të vitit ushtrimor, administratori, merr masa pér përgatitjen e bilancit. Bilanci u paraqitet ortakëve pér miratim, brenda afateve ligjore.
- 16.2 Asambleja e Ortakëve që miraton bilancin vjetor, vendos mbi shpërndarjen e fitimit të ortakëve ose krijimin e rezervave si dhe krijimin e rezervave ligjore.

#### **Neni 17**

##### **Likuidimi dhe prishja**

Likuidimi dhe prishja e Shoqërisë vendoset dhe kryhet në përputhje me kërkesat ligjore.

#### **Neni 18**

##### **Dispozita mbyllëse**

Ky Statut hartohet në dy ekzemplarë në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore.

##### **ORTAKET**

##### **"The Brief Agency SHPK"**

**Gentian Minga**



